




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO		AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGJENCIA PROTIV KORRUPCJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. <u>2-D/DPK</u>	Nr. Prot. Br. Prot. <u>01-4126/13</u>	Data Datum <u>02.12.2013</u>	
Nr. i faq. Broj stranica <u>02</u>	Date Date <u>02.12.2013</u>		
PRISHTINE			



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGJENCIA PROTIV KORRUPCJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 24 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 02/2013 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 21.11.2013, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-2778/13, për z. Gani Mustafa – Drejtor i Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit në Komunën e Artanës (Novobërdes), për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrothana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funkcionit Publik për zyrtarin e lartë, z. Gani Mustafa – Drejtor i Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit në Komunën e Artanës (Novobërdes), dhe njëkohësisht person i autorizuar në një biznes privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.

Në rastin e lartëpërmendur, zyrtari i lartë z. Mustafa është hetuar për situatë të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit (me datë 25.09.2013), pas së cilës zyrtari është paraqitur në takim me zyrtarët e Agjencisë. Me këtë rast ai është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet si dhe me ndryshimet të cilat duhet ti bëj për të parandaluar situatën e mundshme të konfliktit të interesit.

Duke parë se procesi i ndryshimeve të nevojshme po zgjatë, Agjencia Kundër Korrupsionit, i ka bërë shkresën e dytë, sipas procedurës ligjore, që njihet me emrin "njoftimi paralajmërues" Z.D/DRK 01-3732/13 me të cilën zyrtarit të lartë i është bërë e qartë se duhet të shmanget situata

e konfliktit të interesit brenda afatit të caktuar, përndryshe do të pasojnë edhe masat tjera sanksionuese të parapara me ligj.

Ndërkohë, pas kësaj shkrese z. Mustafa ka dërguar në Agjenci informacionin zyrtar të lëshuar nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë(DPKI.03- 3972/13) në të cilën vërtetohet se i njëjti ka hequr dorë nga pozita e personit të autorizuar që kishte në Sh.P.K "TINA" për të ushtruar funksionin e tij publik si Drejtor i Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit në Komunën e Artanës (Novobërdes), me çka ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Hasan Preteni
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

